



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2025

VENDIM
Nr. 768, datë 22.10.2025

PËR
NGRITJEN NË DETYRËN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020, “*Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve*”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile të shpallur me Vendimin e tij nr. 635, datë 31.10.2024, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Ngritjen në detyrë e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 27.10.2025.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR